



ALBGAS sh.a.

OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR

ZYRTARI I PËRPUTHSHMËRISË

Nr. _____ Prot

Tiranë, më / /2021

RAPORTI VJETOR I PËRPUTHSHMËRISË

2020

**Mbi zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në Sektorin e Gazit
Natyror nga ALBGAS Sh.a.**

ALBGAS Sh.a

Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror

Njësia Administrative Nr. 5, Rruga e Kosovarëve,

Pallati Ndër Pro, Tiranë, Shqipëri

www.albgaz.al

NUIS: L71306034U

RAPORTI VJETOR I PËRPUTHSHMËRISË

2020

**Mbi zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në Sektorin e Gazit
Natyror nga ALBGAZ Sh.a.**

Tiranë, 2021

Ky raport është përgatitur në bazë të informacionit që është vënë në dispozicion nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror ALBGAZ Sh.a., Zyrtarit të Përputhshmërisë së Shoqërisë gjatë përmbushjes së përgjegjësisë së tij në vitin 2020.

Në zbatim të kërkesave të nenit 47, nenit 16 pika 7 të Ligjit 102/2015 datë 23.09.2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe vendimit të ERE nr.77, datë 26.05.2017, raporti vjetor do të publikohet në dy gjuhë në faqen zyrtare të internetit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Gazit - ALBGAZ Sh.a (www.albgaz.al) brenda pesë ditëve nga paraqitja e tij në gjuhën shqipe Entit Rregullator të Energjisë (ERE). Raporti duhet të ketë përfunduar deri më 31 mars të çdo viti.

Përgatiti:

Elvis Ponari MBA, MSc

Zyrtari i Përputhshmërisë

Email: elvis.ponari@albgaz.al

SHKURTIME DHE PËRKUFIZIME

ALBGAZ sh.a: Operatori i Kombinuar i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Nat.

ALBPETROL sh.a: Shoqëria publike e kërkimit Prodhimit të Naftës dhe Gazit

ERE: “Enti Rregullator i Energjisë”

OSSH/DSO: “Operator i Sistemit të Shpërndarjes”

ALBGAZ/TSO: “Operator i Sistemit të Transmetimit”

ENTSO-G: është Rrjeti European i Sistemit të Operatorëve të Transmetimit të Gazit (observer)

MIE: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

GNL: “Gaz Natyror i Lëngshëm”

MEDREG: Shoqata e Rregullatorëve të Energjisë dhe të Gazit Natyror për rajonin e Mesdheut

ECRB: Bordi i Rregullatorëve të Energjisë të vëndeve të Komunitetit të Energjisë

ACER: Agjencia për kooperim e rregullatorëve të energjisë për Europën.

CEER: Këshilli European i Rregullatorëve të Energjisë

GRI SSE: Inisiativa e Rregullatorëve për Grupin e Gazit për Rajonin Jug-Jug lindje

IGU: Unioni Ndërkombëtar i Gazit, jemi anëtarë me të drejta të plota

OME: Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë

UfM: Unioni për Mesdheun

Përmbajtja

PJESA E PARË	6
1. Hyrje	6
2. Shoqëria	8
3. Programi i Përputhshmërisë	11
A. Ndarja dhe pavarësia	11
1. Ndarja	11
2. Pavarësia drejtuese	11
3. Pavarësia funksionale dhe Vendimarrëse	12
B. Përjashtimi i sjelljes diskriminuese	15
1. Aksesi në sistemin e transmetimit	15
2. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale	15
3. Konflikti i interesit	15
C. Politika e informacionit të kompanisë ALBGAZ	16
1. Sigurimi i informacionit	16
2. Konfidencialiteti i informacionit	16
3. Informacioni publik	17
D. Zbatimi i Programit të Përputhshmërisë	17
PJESA E DYTË	18
4. Rekomandimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë	18
PJESA E TRETË	18
6. Detyrat specifike të lëna nga ERE mbas miratimit të Raportit 2020	18
PJESA E KATËRT	19
7. Konkluzione	19

PJESA E PARË

1. Hyrje

Në mbështetje të ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, (botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 178, datë 15.10.2015), në zbatim të kërkesave të nenit 47, Programi Tip i Përputhshmërisë është miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me Vendim Nr. 77, datë 26.05.2017 “Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”. Gjithashtu në mbështetje të nenit 21 të Direktivës 2009/72/EC e datës 13 Korrik 2009 “Mbi rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të energjisë që shfuqizon Direktivën 2003/54/EC” u hartua ky raport. Raporti vjetor u hartua në bazë të detyrave të Zyrtarit të Përputhshmërisë, Z. Elvis Ponari MBA, MSc (Zyrtari), miratuar me Vendimin Nr. 233, datë 16.10.2018, “Mbi miratimin e “Kërkesave minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse” dhe miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së ALBGAZ të Gazit Natyror nga ERE.

Ky raport vjetor i Përputhshmërisë që hartohet **për herë të tretë** si pjesë e kompetencave ligjore të aktivitetit të Zyrtarit të shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. (ALBGAZ) në lidhje me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë, ka synuar të prezantojë mekanizmin për zbatimin e këtij Programi, përcaktimin e detyrave funksionale dhe detyrimeve të punonjësve të ALBGAZ në lidhje me këtë Program, duke u mbështetur në monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programi.

Në këtë raport vjetor përputhshmërie parashtrohet monitorimi dhe mbarëvajtja e procesit sipas Programit të Përputhshmërisë të miratuar për herë të parë në 2020 nga Këshilli Mbikëqyrës i ALBGAZ me vendim Nr.18, datë 04.11.2020 mbi “miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”, miratuar në ERE me vendim nr. 263, datë 28.12.2020. ‘Mbi fillimin e procedurës për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, ‘Albgaz’ sh.a’.

Programi nxjerr një Raport vjetor, i cili bazohet në sigurimin e shmangies së sjelljeve diskriminuese të ALBGAZ-së ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të gazit natyror dhe përdoruesve të rrjetit, pavarësisë së ALBGAZ, konfidencialitetin e të gjithë informacionit të menaxhuar nga ALBGAZ-ja si dhe transparencës së procedurave të ndjekura prej saj përgjatë periudhës 1.1.2020 – 31.12.2020.

Zyrtari konstantoi që ALBGAZ është në përputhje me standartet e industrisë, ligjet, rregullat dhe rregulloret e përcaktuara nga ERE. Zyrtari gjatë vitit 2020 e analizoj kompaninë sipas Programit dhe ushtroi detyrën e tij që Programi të zbatoheshe nga kompania. Gjithashtu përgjatë 2020 Zyrtari është kujdesur që kompani të respektoj dhe rregulloret ndërkombëtare. Për të përmbushur çdo kërkesë për përputhshmërinë, Zyrtari sëbashku me ALBGAZ kanë bashkëpunuar për të krijuar rregullore, udhëzime, trajnime, prezantime, dhe procese në mënyrë aktive në mënyrë që kompania dhe stafi i saj të jetë sa më në përputhshmëri me Programin.

Raporti i vitit 2020 parashtrori disa rekomandime që duhet të ishin plotësuar përgjatë 2020. Për përmirësimin e punës në ALBGAZ dhe përmbushjet e detyrimeve të Programit. Këto rekomandime do shqyrtohen në këtë raport.

Rekomandimet ishin:

Zyrtari i Përputhshmërisë, ALBGAZ SH.A.

Faqe 6

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2020

- Përditësimi i faqes zyrtare të ALBGAZ për të përfshirë Programin e Përputhshmërisë
- Përmirësimi i Kodit të Etikës duke përfshirë dhe Programin
- Manual Pune: Parimet e Programit të Përputhshmërisë
- Udhëzues për Politikën e klasifikimit të dokumentacionit
- Përditësim/përmirësim i Programit
- Aplikacion/mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Programit të Përputhshmërisë.
- Paraqitja e teknikave të reja për trajnimet e stafit

Sipas komunikimit të vazhdueshëm midis Zyrtarit dhe ALBGAZ dhe me shkresën kthim përgjigje “Dhënie informacioni për masat e marra për rekomandimet e Raportit Vjetor të Përputhshmërisë për vitin 2020” nga ALBGAZ, Nr. Prot 189, datë 03.11.2020 thuhet:

1. Përditësimi i faqes zyrtare është në punim e sipër dhe sipas të dhënave të Zyrtarit është përmbushur si detyrë.
2. Përmirësimi i Kodit të Etikës kërkohet nga ALBGAZ një specifikim nga Zyrtari se cila pjesë e Programit të përfshihet në të. Përgjatë 2021 do të krijohet një grup pune dhe në varësi të gjendjes dhe pandemisë do zhvillohet në 2021.
3. Manual Pune: Parimet/udhëzues për Politikën e Programit është e ezauruar pasi Zyrtari komunikon me ALBGAZ dhe trajnon stafin e ri për programin, ALBGAZ ka përcjellur tek të gjithë udhëzuesin e krijuar nga Zyrtari, dhe komunikimi është shumë i mirë. Quket e ezauruar.
4. Kanal komunikimi është e ezauruar pasi është përfshirë shumë mirë tek website i ALBGAZ.
5. Udhëzues mbi politikën e klasifikimit të informacionit quhet e ezauruar pasi është shumë mirë e përfshirë në Kodin e Etikës. Duhet rishikuar vitet e ardhshme nëse ka nevojë për përditësim.
6. Përditësimi i programit quhet i pa ezauruar pasi është një detyrë që çdo vite kërkon dhe duhet të përditësohen ligjet dhe rregulloret. Duhet të kihet parasysh nga ALBGAZ dhe Zyrtari.
7. Aplikacion/mekanizëm për monitorimin e raportimit dhe zbatimit të Programit quhet e ezauruar pasi raportohet dhe mbahet shumë mirë dhe në detaje tek Zyrtari.
8. Paraqitja e teknikave të reja dhe zgjerim i burimeve njerëzore quhet e plotësuar nga ALBGAZ dhe gjithashtu duhet të vazhdojë pasi sektori i gazit kërkon vazhdimisht trajnime dhe zgjerime të stafit.

Përgjatë vitit 2020 vëj në dukje komunikimin më të rëndësishëm për ALBGAZ dhe përsa i përket përputhshmërisë.

- Duhet vënë në dukje që ERE më në fund me Vendim nr. 263, datë 28.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “ALBGAZ” sh.a.” miratoj programin.
- Gjithashtu për arsye të qarta duhet vënë re që ALBGAZ nuk ka arritur të plotësojë kushtet për licensim dhe për certifikimin, 2 herë, duke kërkuar shtyrje të afateve për plotësimin e dokumentacionit përkatës sipas vendimit të ERE nr.108 datë, 02.07.2020 “për licensimin e ALBGAZ” dhe vendimi i ERE nr. 109 datë, 02.07.2020 “për certifikimin e ALBGAZ” dhe vendim ERE nr. 261 datë, 28.12.2020 “për licensimin e ALBGAZ” dhe vendimi i ERE nr. 262 datë, 28.12.2020 “për certifikimin e ALBGAZ”.

- Duhet vënë në dukje gjithashtu që ALBGAZ vjet aplikoj për licensën për magazinimin dhe ka kërkuar shtyrjen, 2 herë, për plotësimin të dokumentacionit sipas vendimit të ERE nr. 119 datë, 17.7.2020 “për shtyrjen e afatit për plotësimin e dokumentacionit” dhe vendim ERE nr. 179 datë, 04.11.2020 “për shtyrjen e afatit për plotësimin e dokumentacionit”
- Duhet theksuar se Me vendim ERE nr. 215 datë, 15.12.2020 është lënë në fuqi e njëjta tarifë për gazin, duke mos ndryshuar për tregun.
- Duhet theksuar dhe ripërmënduar që ALBGAZ dhe ALBPETROL nuk kanë patur mundësi të përmbushnin kontratën e furnizimit me ngaz, edhe pas disa shkresave të ALBGAZ nr. 178 datë 13.10.2020, nr. 134 datë, 6.7.2020, nr. 94 datë 12.5.2020, nr. 70 datë 4.3.2020 drejtuar dhe rikujtuar ALBPETROL për sasinë e gazit që ju nevojitet për vitin 2020, ALBGAZ nuk ka marrë përgjigje. ALBGAZ duke mos patur rrjet gazi dhe atë që ka e ka me kapacitet minimal një nga klientët e tij dhe më të rëndësishmit është ALBPETROL.
- Duhet theksuar rregullorja mbi “fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e procedurave për dhënien e së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror” vendim i ERE nr. 148, datë, 10.09.2020. Një rregullore shumë e rëndësishme sa për zhvillimin e tregut të gazit dhe të garantojë rregulla jo diskriminuese për funksionimin e tregut të gazit natyror.
- Duhet theksuar një rikujtese nga ERE për rregulloren e miratuar me vendim ERE nr. 100, datë 21.06.2020 për miratimin e “rregullores për përcaktimin e kriterëve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”, ALBGAZ ka kërkuar shtyrjen pasi nuk e plotëson dot deri më 21.06.2021.
- Duhet theksuar pavarësisht të gjithave në shumicën e rasteve nuk është marrë parasysh mendimi apo është informuar Zyrtari. Tek shkresa ERE nr 1161 prot. Datë 2.11.2020 me lëndë “ftesë për opinion për monitorimin e tregut të gazit natyror” dhe shkresa nr. 1160 prot. Datë 02.11.2020 me lëndë “ftesë për opinion për kodin e matjes të gazit natyror” nuk është informuar Zyrtari pavarësisht se ALBGAZ ka vijuar me komunikimin me ERE-n.
- Duhet theksuar një pikë kyçe ku preket me shumë imtësi një nga kërkesat për certifikim dhe licensimin e ALBGAZ, që është – transferimi i kompetencave të ALBGAZ tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Me shkresën e ALBGAZ nr. 118/1prot. Datë 09.06.2020 kanë cituar që mae anë të shkresave nr. 68 datë 03.03.2020 dhe shkresa nr. 92 datë 07.05.2020 drejtuar Asamblesë së përgjithshme të ALBGAZ “për ndryshimin e pronarit të ALBGAZ”, nuk kanë marrë një përgjigje zyrtare.
- Duhet theksuar shkresa e ALBGAZ me kthim përgjigje ERE nr. 54 prot datë 10.02.2020 “mbi pëanin 10 vjeçar të zhvillimit të rrjetit” është përcjelluar plani 10 vjeçar por i pa miratuar nga Këshilli mbikëqyrës i ALBGAZ.
- Në shkresën e ALBGAZ me kthim përgjigje ERE nr. 54/2 daë 10.06.2020 tregon për cilat faza të plani 10 vjeçar po plotësohen por për shkak të situatës nuk janë plotësuar të gjitha.
- Duhet theksuar shkresa e ALBGAZ si kthim përgjigje ERE nr. 95/3 datë

Për plotësimin dhe prodhimin e dokumentacionit që nevojiten për raportin vjetor, një nga kërkesat dhe detyrat e Zyrtarit kërkuar tek ALBGAZ, ka patur vonesa për arsye të ndryshme, por me ndihmën e Zyrtarit së bashku me stafin e ALBGAZ u finalizuan në kohë. Më poshtë ju lutem gjeni të dhënat që i përkasin raportit për vitin 2020.

2. Shoqëria

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2020

ALBGASZ është një shoqëri aksionare me 100% të aksioneve të zotëruara nga shteti me aksionar të vetëm Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), e krijuar me Vendimin Nr. 848, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë “ALBGASZ” sh.a. Selia qendrore e kompanisë ndodhet në qytetin e Tiranës. Gjithashtu kompania ka një zyrë përfaqësimi në qytetin e Fierit.

ALBGASZ është certifikuar nga ERE si një **transmetues i kombinuar gazi dhe shpërndarës** me Vendimin e Bordit të ERE nr. 179, datë 8.11.2017 "Për certifikimin e kompanisë si Operator i Kombinuar i Gazit Natyror". Me vendimin nr. 187, datë 10.11.2017 është licensuar si kompani në veprimtarinë e **shpërndarjes** së gazit natyror, dhe vendimin nr. 188, datë 10.11.2017 është licensuar si kompani në veprimtarinë e **transmetimit** të gazit natyror. Përgjatë vitit 2020, ERE e ka miratuar me vendimin Nr. 190, datë 25.11.2020 “Mbi kërkesën e shoqërisë ALBGASZ për licensimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror”. Të treja akoma të paplotësuara dhe të shtyra për plotësim në vitin 2021. Por me Vendimi nr.204, datë 04.12.2020. “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e ‘‘Rregullores për përcaktimin e kritereve për ushtrimin e aktivitetit të depozitimit të gazit natyror’’”.

Rrjeti i tubacioneve në pronësi të ALBGASZ është i shpërndarë në të gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë dhe përfundon në ORC në Ballsh. Infrastruktura vendase e rrjetit të gazit në Shqipëri ka një shtrirje më të madhe se infrastruktura e naftës. ALBGASZ ka informuar se aktualisht është në procesin e evidentimit në terren, vlerësimin teknik të integritetit të linjave teknologjike dhe tubacioneve nëntokësore si dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis, për efekt të paisjes me Lejen Mjedisore

Fushat e gazit shtrihen nga Durrësi deri në Delvinë, duke krijuar kështu një mundësi për konsumatorët për t’u lidhur me rrjetin. Infrastruktura e kufizuar e gazit vendas në Shqipëri në disa pjesë të saj është jashtë gjendjes operative dhe nevojiten punime të mëdha rehabilitimi. ALBGASZ administron rreth 500 km tubacione magjistrale të transportit të gazit të ndertuar para më shumë se 40 vjetesh. Mendoj që tani ato janë me një teknologji tashmë të vjetëruar, ku masat mbrojtëse nga korozioni janë minimale.

Aktualisht objekti kryesor i aktivitetit të ALBGASZ si një operator i kombinuar, është të ofrojë transportimin dhe shpërndarjen e gazit natyror nëpërmjet rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, dhe në të ardhmen të ofrojë edhe aktivitetin e depozitimit nëntokësor të gazit natyror dhe të impiantit të gazit natyror të lëngëzuar.

ALBGASZ si operator i kombinuar i gazit përgjatë 2020 ka proceduar për mbylljen e kërkesave ligjore përsa i përket certifikimit dhe licensimit të shoqërisë me shkresat vendim ERE nr. 262 datë 28.12.2020 “mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “për licensimin e shoqërisë ALBGASZ sh.a., në aktivitetin e shpërndarjes të gazit natyror”, të ndryshuar në vendimin e bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “për licensimin e shoqërisë “ALBGASZ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror” të ndryshuar. ERE konstantoi: të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit Nr. 187, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

“Të licensojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.12.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar.

2. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit Nr. 188, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më

poshtë:

“Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.12.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar.

Dokumentacioni i cili duhet të plotësohej nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a. deri në datën 20.12.2020, sipas vendimeve të Bordit Nr. 187/2017 dhe Nr. 188/2017 sipërcituar, është si më poshtë:

- Pajisja me Lejet dhe Autorizimet Mjedisore (neni 9, pika 1, germa “d”, vi), e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”.
- Depozitimi në ERE i një Certifikatë Sigurimi (neni 9, pika 1, germa “e”, iv), e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”.
- Në ERE ka mbërritur shkresa e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., nr. 144/1 prot., datë 17.12.2020, protokolluar në ERE me nr. 1283 prot, datë 18.12.2020, “Kërkesë për shtyrje afati të vendimit mbi licencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a.”, nëpërmjet së cilës shoqëria ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 20.06.2021.

Kjo kërkesë vjen nga pamundësia e shoqërisë Albgaz sh.a. për të plotësuar brenda afateve kushtet e vendimeve të licencimit, në referim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 4.03.2020, për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë si dhe masave që vazhdojnë të merren në vend për parandalimin e përhapjes së kësaj pandemie.

- Kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit të nevojshëm është depozituar përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 108, datë 02.07.2020 dhe duke marrë parasysh të gjitha kufizimet e vendosura gjatë kësaj periudhe me qëllim parandalimin e përhapjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19, vlerësojmë se shoqëria ndodhet në kushtet e pamundësisë për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm.

ERE me këtë vendim vendosi të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

- “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.06.2021, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar.” *Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë: - “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.06.2021, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar.*

Dhe me vendim ERE vendim nr. 261 datë 28.12.2020 mbi “ mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 189, datë 08.11.2017, “mbi certifikimin e shoqërisë ALBGAZ”. U vendos që ALBGAZ të marrë masa për të plotësuar kushtin e vendosur në pikën 5.2 të vendimit Nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” ALBGAZ sh.a.”, i ndryshuar, brenda datës 20.06.2021.

3. Programi i Përputhshmërisë

Parimet e programit që qeverisin aktivitetin e ALBGAZ sipas shkresës së ALBGAZ nr. 142/5 Prot datë, 18.10.2020 “kthim përgjigje shkresa nr. 142/4 prot datë, 14.10.2020”

Monitorimi i përbushjes së këtyre detyrimeve është bazuar në katër parimet themelore (**ndarja dhe pavarësia, aksesit dhe shpërdarja e informacionit, përjashtimi i sjelljes diskriminuese dhe zbatimi i rregullt i programit**) të programit sipas Vendimit të Bordit të ERE Nr. 77, datë 25.06.2017 “Mbi Miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”, shqyrtohet se si aktiviteti i ALBGAZ duhet të qeveriset sipas standarteve që përcakton legjislacioni në fuqi.

Në këtë raport vjetor përputhshmërie parashtrohet monitorimi dhe mbarëvajtja e procesit sipas Programit të Përputhshmërisë.

Kërkesat dhe parimet e mëposhtme rregullatore duhet të konsiderohen prioritare për ALBGAZ, dhe çdo strukturë e saj është e detyruar të realizoj dhe kërkojë përputhshmërinë me këto kërkesa dhe parime.

A. Ndarja dhe pavarësia

1. Ndarja

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 142/5 Prot datë, 18.10.2020 “kthim përgjigje shkresa nr. 142/4 prot datë, 14.10.2020”

- **ALBGAZ i plotëson kërkesat e programit** pasi zhvillon aktivitetin e saj të ndarë nga aktivitetet e tjera që nuk kanë lidhje me transmetimin e gazit natyror në përputhje me Nenin 36 të Ligjit Nr. 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror. Gjithashtu, ALBGAZ është një person juridik i ndarë që nuk është pjesë e kompanive vertikalisht të integruara ose pjesë e strukturës së korporatës dhe nuk kryen dhe as nuk është e angazhuar në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të gazit natyror dhe energjisë elektrike. **Duhet riparë gjithësesi që pronari i ALBGAZ të ndryshohet sa më parë konform ligjit dhe direktivave të energjisë.**
- ALBGAZ sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit , dhe shkresës së ALBGAZ nr. 142/5 Prot datë, 18.10.2020 “kthim përgjigje shkresa nr. 142/4 prot datë, 14.10.2020”: ka siguruar dhe garantuar ndarjen e duhur të ALBGAZ, duke marrë masa që i njëjti person ose të njëjtët persona të emëruar, anëtarë të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ALBGAZ të mos kenë të drejtë që njëkohësisht të ushtrojnë kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendimmarrjen e subjektit që kryen veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror, si dhe të jenë anëtarët të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike e të gazit natyror dhe veprimtarinë e ALBGAZ ose rrjetit të transmetimit.

2. Pavarësia drejtuese

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe nën pikat e saja, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 142/5 Prot datë, 18.10.2020 “**kthim përgjigje shkresa nr. 142/4 prot datë, 14.10.2020**”: **ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit** duke marrë masa që për të arritur pavarësinë e drejtuesve. Për sa i përket pavarësisë së drejtuesve të ALBGAZ, të tillë si Anëtarët e Bordit Mbikqyrës, Administratori, kryetarët dhe personeli udhëheqës (drejtuesit e njësive strukturore), janë të pavarur nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e saj. Për këtë qëllim, janë zbatuar kërkesat e mëposhtme:
- Drejtuesit e ALBGAZ nuk janë të lidhur profesionalisht me kompani vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të këtyre.
- Drejtuesit e ALBGAZ nuk kanë interes apo marrin përfitime financiare në mënyrë të drejtperdrejtë ose të tërthortë, për kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre.
- Pagat e drejtuesve në ALBGAZ vendosen në bazë të elementëve të paracaktuar që kanë lidhje me performancën e ALBGAZ, siç specifikohet tek kontrata e punësimit dhe/ose tek udhëzimet e punësimit.
- Transferimi i drejtuesve të ALBGAZ tek kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, dhe anasjelltas, është parashikuar të bëhet sipas kushteve transparente të vendosura qartë tek Statuti i ALBGAZ dhe do ndiqet rregullisht, dhe asnjë nga këto transferime nuk duhet të paracaktohen që në fillim. Drejtuesit e ALBGAZ nuk kanë aksione të kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, dhe nuk ka konflikte të mundshme interesi që kanë lidhje me këto aksione.

3. Pavarësia funksionale dhe Vendimarrëse

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 142/5 Prot datë, 18.10.2020 “**kthim përgjigje shkresa nr. 142/4 prot datë, 14.10.2020**”: **ALBGAZ ka pavarësi totale funksionale dhe Vendimarrëse.** ALBGAZ mbështetur në Ligjin nr.102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror, si dhe akteve të tjera ligjore dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit është përgjegjës për dhënien aksesit për palët e treta, përfshirë mbledhjen e detyrimeve të aksesit dhe detyrimeve të kongestionit, për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit si dhe për të siguruar një mundësi afatgjatë të sistemit të transmetimit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme përmes planifikimit të investimeve. Me zhvillimin e sistemit të transmetimit, ALBGAZ është përgjegjëse për planifikimin (duke përfshirë procedurën e autorizimit), ndërtimin dhe autorizimin e infrastrukturës së re të gazit. ALBGAZ është e pavarur në planifikimin e investimeve në lidhje me sistemin e transmetimit sipas kërkesave të Ligjit 102/2015 dhe akteve të tjera ligjore në zbatim, dhe duhet të përputhet me planin e miratuar dhjetë-vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe të monitorohet nga Enti Rregullator i Energjisë. ALBGAZ mban në dispozicion burimet e kërkuara financiare, teknike, fizike dhe njerëzore për të kryer detyrat e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror.

Në 15 Nëntor 2020, Projekti TAP përfundoi. Momenti i datës Komerciale të Vendosjes në Funksion (COD) në datën 15 Nëntor, përbën fillimin e periudhës 25 vjeçare të përjashtimit nga aksesi i palëve të treta, rregullimi i tarifave dhe veçimi i pronësisë. Që nga kjo datë dhe në vazhdim,

Transportuesit e TAP duhet të paguajnë tarifa, si përcaktohet sipas Kodit të Tarifave të TAP dhe publikuar tek faqja zyrtare e TAP.

Tashmë ka filluar Market Testi për zgjerimin e kapacitetit. Ai është harmonizuar me dispozitat e Opinioni Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përfundimit të TAP AG, datë 6 Qershor 2013, lëshuar nga Autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC, (‘Opinioni Përfundimtar i Përbashkët’) i Kodit të Tarifave të TAP me Rregulloren e BE 2017/459 duke krijuar kodin e rrjetit mbi Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit tek sistemet e transportit të gazit (“CAM NC”).

Për kapacitetin e tij fillestar, TAP përjashtohet nga dispozitat e aksesit të palëve të treta, tarifat e rregulluara dhe veçimi i pronësisë sipas afateve të Opinioni Përfundimtar të Përbashkët. Përjashtimi nga tarifat e rregulluara dhe veçimi i pronësisë po ashtu aplikohet për Kapacitetin e Zgjerimit aktual të ndërtuar të TAP.

Testimi i Tregut është një procedurë transparente, e hapur dhe jo diskriminuese. Proçesi pasqyron kontekstin Rregullator unik dhe specifik të Transportuesit dhe përfshin udhëzimet se si TAP do të marrë pjesë në proçesin e gjerë për rritjen e kapacitetit të përcaktuar në Kapitullin V të Mekanizmit për Alokimin e Kapacitetit të Kodit të Rrjetit.

Duhen përmënduar dhe:

- Vendimi nr.145, datë 28.08.2020.”Mbi fillimin e procedurës për miratimin e draftit të ‘‘Kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi public i furnizimit’’.
- Vendimi nr.68, datë 22.04.2020, ‘‘Mbi miratimin e ‘‘Kodit të Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror’’ në Shqipëri’’.
- Vendimi nr.218, datë 15.12.2020. ‘‘ Mbi fillimin e procedurës për miratimin e standarteve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit’’.

ALBGAZ ka ushtruar dhe shumë aktivitete të tjera në sektorin e brëndshëm dhe ja vlen të përmendin ku në cilësinë e Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror në Republikën e Shqipërisë, veprimtaria e të cilës liçensohet dhe rregullohet sipas dispozitave të ligjit 102/2015 ‘‘Për Sektorin e Gazit Natyror’’, paraqesim zhvillimet kryesore përgjatë vitit 2020 si më poshtë:

Së pari, gjatë vitit 2020, Albgaz sh.a ka kushtëzuar si asnjëherë më parë mbarëvajtjen operative të shoqërisë si dhe është detyruar në pezullimin apo shtyrjen e projekteve që rrjedhin nga Gaz-Mastërplani, reflektuar këto nëpërmjet VKM nr. 87/2018.

Megjithëse viti pandemik ngriti sfida të papreçedenta për departamente të ndryshëm, disa arritje u realizuan kryesisht në kuadrin rregullator, të ngritjes së kapaciteteve dhe të dyja projekteve si më poshtë:

1. Bashkëpunim për Kodin e Rrjetit të Transmetimit
2. Aplikimi për Liçencë si Operator i Sistemeve të Depozitimit.
3. Kodin e Matjes së Gazit Natyror
4. Ngritja e kapaciteteve të Albgaz sh.a, është marrë përsipër nga konsulenti i pajtuar Economic Consulting Associates Ltd
5. Albgaz realizoi procedurat për projektimin dhe ndërtimin e dyja qëndrave të mirëmbajtjes së Gazsjëllësit TAP në Shqipëri, konkretisht: Qendra e Mirëmbajtjes në Fier (në operim) dhe Qendra e Mirëmbajtjes në Korçë në faze ndërtimi, pas përfundimit të procedurave tenderuese. Këto projekte u realizuan në kuadër të marrëveshjes ndërmjet TAP AG dhe Albgaz sh.a me objekt realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së

- gazsjellësit nëpërmjet ndërmarrjes së përbashkët Albanian Gas Services Company SHA.
6. Projekte të tjera potenciale të cilat nuk vazhduan në fazat pasardhëse.
 - a) Projekti PIP01, Fier CP-Vlora TPP, vazhdon të ndiqet nga Albgaz sh.a me shumë interes, pasi projekti potencialisht përfshin drejtpërdrejt kompaninë si operator të rrjetit të transmetimit.
 - b) Ndjekja dhe zbatimi i kërkesave që rrjedhin nga procedurat për krijimin e projektit Jonian Adriatik Pipeline (IAP).
 - c) Ndjekja e punës pas studimit të fizibilitetit për projektin e interkoneksionit me Kosovën, ALKOGAP.
 7. Albgaz është përfshirë në procesin e negociimit Teknik dhe atij ligjor përse i përket marrëveshjes në lidhje me pikën e lidhjes në Korçë(Exit Point) me TAP, proces i cili është në vijim dhe në koordinim të plotë me aktorët e tjerë të interesit duke përfshirë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si përfaqësuese e interesave të shtetit shqiptar.
 8. Aktivitetit i Albgaz është një proces kompleks, i shtrirë në kohë, sepse aktivitete të tilla, si ato në sektorin e gazit, janë shumë intensive në “investime kapitale”, si në volume projektimi dhe financimi, ashtu dhe në shtrirje kohore, por rezultati final i tyre i pritshëm dhe gradual është:
 9. Kërkimi Tekniko-Financiare për realizmin e një “projektit pilot” të LNG në “shkallë të vogël” (small scale LNG);
 10. Krijimi i kushteve për përfundimin e investimeve të huaja direkte në këtë segment të ekonomisë;
 11. Rritja e punësimit në sektor dhe në industritë që kanë impakt prej sektorit të gazit;
 12. Përmirësimi i furnizimit me energji në nivel industrial, shërbimesh dhe rezidencial;
 13. Krijimi i kushteve për zhvillim të qëndrueshëm industrial dhe ulje kostosh energjitike në nivel prodhimi “mallrash dhe shërbimesh”;
 14. Ulje në përgjithësi e “faturës energjetike” të konsumatorit familjar fundor;
 15. Krijimi i kapaciteteve njerëzore në vend në drejtim të para-projektimit, projektimit, menaxhimit të investimeve duke rezultuar në zbatimin efektiv dhe eficient të aktiviteteve përkatëse në industrinë e gazit;
 16. Konsolidimi i bashkëpunimit institucional me agjensitë europiane si ENTSO-G, GIE dhe me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë ECS.

Viti 2021 e pret ALBGAZ me zhvillimi në fushën e gazit si:

- Bashkëpunimi me Entet Rregullatore të Energjisë së shteteve fqinje, Greqi dhe Itali, si dy shtete anëtare të BE-së, koordinimi i të gjitha akteve nënligjore dhe rregulloreve në përputhje me Direktivën 2009/EU dhe Rregulloren 715/EU, dhe një sërë rregulloresh të tjera që kanë të bëjnë me transparencë, diskriminimin e palëve të treta si dhe marjen e vendimeve të përbashkëta për këtë qëllim
- Bashkëpunimi me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vienë për akte e tjera të nënligjore dhe përmirësimin e atyre ekzistuese si dhe konsulenca e vazhdueshme për problemet që dalin gjatë implementimit të Direktivave dhe të Rregulloreve
- Bashkëpunimi me Ministrinë së linjës(MEI) për domosdoshmërinë e ndërtimit të infrastrukturës së gazit, si një nevojë urgjente për hapjen e tregut të gazit natyror në vëndin tonë. Aktualisht gazi është prezent dhe duhet që të filloj përdorimi i tij. Janë identifikuar pesë projekte prioritare të miratuara edhe nga Këshilli i Ministrave dhe kërkohet fillimi i ndërtimit të tyre, sigurisht sipas prioritetit që ato kanë.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2020

- Bashkëpunimi me Ministrinë e linjës (MIE) për amendimin e ligjit nr.102/2015 ‘‘Për Sektorin e Gazit Natyror’’, ndryshuar, për plotësimin e kushteve të çertifikimit të Operatorit të Transmetimit të Gazit Natyror, Albgaz sh.a.
- Bashkëpunimi me Albgaz sh.a, në aspektin rregullator, për të gjitha problemet që hasen për hapjen e tregut të gazit natyror, kualifikimin, transparencën dhe përmirësimin e akteve të domosdoshme.
- Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare dhe Ndërkombëtare për problemet e gazit si; CEER (Këshilli European i Rregullatorëve të Energjisë), ACER(Agency for the Cooperation of Energy Regulators) Agjencia për Kooperim e Rregullatorëve të Energjisë për Europën), GRI SSE, SOUTH SOUTH-EAST GAS REGIONAL INITIATIVE(GRI SSE, (Inisiativa e Rregullatorëve për Grupin e Gazit për Rajonin Jug-Jug lindje), MEDREG, Working Group Gas Natural, Shoqata e Rregullatorëve të Energjisë dhe të Gazit Natyror për rajonin e Mesdheut, ENTSO-G (Observër në Shoqatën e Sistemit të Transmetimit European të gazit), IGU (Unioni Ndërkombëtar i Gazit), OME (Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë), ECRB, Gas Working Group, Bordi i Rregullatorëve të Energjisë të vëndeve të Komunitetit të Enrgjisë, marja pjesë në studimet e tyre dhe mundësia e thithjes së investimeve të huaja për zhvillimin e infrastrukturës në vëndin tonë.

B. Përfundimi i sjelljes diskriminuese

Kushtet dhe procedurat përcaktohen në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të Transmetimit të Gazit, për të parandaluar ndonjë trajtim diskriminues nga ana e ALBGAZ.

1. Akses në sistemin e transmetimit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ **nr. 142/5 Prot datë, 18.10.2020 ‘‘kthim përgjigje shkresa nr. 142/4 prot datë, 14.10.2020’’**: ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit duke marrë masa të sigurojë akses të barabartë dhe jo diskriminues.

2. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafit të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ **nr. 142/5 Prot datë, 18.10.2020 ‘‘kthim përgjigje shkresa nr. 142/4 prot datë, 14.10.2020’’**: ALBGAZ i plotëson kërkesat e programit. Për sa i takon konkurrencës dhe marrëdhënieve komerciale, përgjate vitit 2020 nuk është raportuar asnjë shkelje apo keqmenaxhim i veprimtarisë tregtare si në përgjithësi ashtu edhe lidhur me raste të vecanta. Aktivitetet e ALBGAZ nuk kufizojnë ose ndikojnë në konkurrencën e drejtë në tregun e gazit natyror

3. Konflikti i interesit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Progamit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ **nr. 142/5 Prot datë, 18.10.2020 ‘‘kthim përgjigje shkresa nr. 142/4 prot datë, 14.10.2020’’**:

ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit. Në lidhje me konfliktet e interesit, përgjatë vitit 2020, nuk është sinjalizuar asnjë shkelje apo abuzim i punonjësve të shoqërisë ALBGAZ nga ana e Bilbilfryresit apo e ndonjë individi tjetër të brendshëm apo të jashtëm të shoqërisë.

C. Politika e informacionit të kompanisë ALBGAZ

ALBGAZ ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të siguruar informacionin, konfidencialitetin dhe transparencën ndaj publikut duke i ofruar akses të barabartë përdoruesve në të gjitha dokumentacionet që disponon pasi është e detyruar të publikojë në faqen zyrtare të korporatës, sipas kuadrit rregullator që rregullon veprimtarinë e saj.

1. Sigurimi i informacionit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ **nr. 142/5 Prot datë, 18.10.2020 “kthim përgjigje shkresa nr. 142/4 prot datë, 14.10.2020”**: **ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit.** Pavarësisht faktit se aktualisht ALBGAZ ka vetëm një përdorues të rrjetit të transmetimit të gazit, ALBGAZ i siguron atij, pjesëmarrësve potencial dhe përdoruesve të mundshëm të rrjetit informacionin e nevojshëm për akses eficient dhe të pa-kufizuar tek sistemi i transmetimit. Ky informacion sigurohet në mënyrë të drejtë, transparente dhe jo-diskriminuese sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror.

2. Konfidencialiteti i informacionit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ **nr. 142/5 Prot datë, 18.10.2020 “kthim përgjigje shkresa nr. 142/4 prot datë, 14.10.2020”**: **ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit.** Nëpërmjet kontratës individuale të punës dhe mekanizmave të tjerë juridik, ALBGAZ siguron konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregëtar, financiare ose teknike të cilat iu vijnë drejtuesve ose punonjësve të shoqërisë gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre profesional. ALBGAZ ruan informacionin konfidencial të cilësuar si të tillë sipas kontratave me furnizuesit e produkteve dhe/ose shërbimeve. Këta furnizues duhet të sigurojnë që drejtuesit dhe punonjësit e tyre, që e marrin këtë informacion konfidencial nga ALBGAZ, ta ruajnë konfidencialitetin në lidhje me këtë informacion. Staf i shoqërisë ka marrë të gjitha masat që materialet që kanë informacion të ndjeshëm tregëtar siç janë (dokumentat, arkivues të të dhënave elektronike, kompjutera, tableta, telefonat etj.) të mbrohen në bazë të protokolleve në fuqi sipas vendit të punës. ALBGAZ gjithashtu nuk shpërndan informacionin e ndjeshëm tregëtar tek ndonjë palë e tretë, përveç rasteve kur: Shpërndarja e informacionit kërkohet shprehimisht nga ligji, duke siguruar që kjo shpërndarje të kryhet sipas një mënyre të përcaktuar me ligj. Drejtuesit dhe/ose punonjësit e ALBGAZ sigurojnë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregëtar të cilët e kanë në dispozicion për shkak të detyrës profesionale. Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e ALBGAZ, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshillëtarët nuk shpërndajnë ose kanë shpërndarë informacion të ndjeshëm

tregtar tek ndonjë palë e tretë gjatë emërimit të tyre, punësimit ose bashkëpunimit me ALBGAZ dhe të paktën 3 (tre) vitet në vazhdim pas mbarimit të emërimit, punësimit, dhe bashkëpunimit (vetëm sipas rasteve të cituara në ligj). Në përputhje me kërkesat e transparencës të ALBGAZ, siguron që të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit të trajtohen në mënyrë jo diskriminuese dhe me kushte të njëjta kur ofrohet informacioni funksional dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me aktivitetet e ALBGAZ. Nëse ndonjë informacion i ndjeshëm tregëtar duhet të shpërndahet, duhet të sigurohet që ky informacion është shpërndarë për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit duke e publikuar atë në faqen e internetit të ALBGAZ. *Zyrtari së bashku me ALBGAZ po draftojnë një rregullore të tillë dhe pritet që stafi të trajnohet nga Zyrtari mbi këto kërkesa.*

3. Informacioni publik

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ nr. **142/5 Prot datë, 18.10.2020 “kthim përgjigje shkresa nr. 142/4 prot datë, 14.10.2020”**: **ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit.** ALBGAZ ka publikuar në faqen e internetit informacionet që nuk klasifikohen si konfidencial ose informacione të ndjeshëm tregëtar duke vendosur në dispozicion të të gjithë pjesëmarrësve, përdoruesve të rrjetit dhe palëve të treta informacionin e lidhur me listën e shërbimeve të ofruara nga ALBGAZ, informacion për tarifatat dhe kushtet e tjera për sigurimin e këtyre shërbimeve, duke përfshirë kushtet teknike për aksesin dhe lidhjen me sistemin e transmetimit.

D. Zbatimi i Programit të Përputhshmërisë

Programi i Përputhshmërisë i miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, është i krijuar i tillë që të ketë formën e një rregulloreje, apo udhëzimi me angazhime të detyrueshme për të gjithë drejtuesit dhe punonjësit, si dhe përfaqësuesit e autorizuar të ALBGAZ, siç janë audituesit, këshilltarët, kontraktuesit, pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit si dhe palët e tjera të treta.

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së ALBGAZ nr. **142/5 Prot datë, 18.10.2020 “kthim përgjigje shkresa nr. 142/4 prot datë, 14.10.2020”**: **ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit.** Referuar vendimit Nr.78 datë 26.05.2017 të ERE, monitorimi i vazhdueshëm për zbatimin, siç duhet, të Programit është kryer nga Zyrtari i Përputhshmërisë i cili ka funksionuar në bazë dhe sipas kompetencave të ofruara sipas Ligjit Nr 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe kontratës së lidhur midis ALBGAZ dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë. Zyrtari i Përputhshmërisë ka ushtruar autoritet të mjaftueshëm në kushtet e duhura financiare dhe organizuese që i kanë mundësuar, propozimin e masave për të siguruar zbatimin e këtij Programi dhe të kërkojë bashkëpunim nga drejtuesit dhe punonjësit e ALBGAZ për të siguruar përputhshmërinë me këtë Program. Zyrtari i Përputhshmërisë ka pasur akses pa limit tek të dhënat e nevojshme në zyrat e ALBGAZ dhe tek gjithë informacioni që i është dashur për të kryer detyrat e tij. Zyrtari i Përputhshmërisë ka pasur akses në zyrat e ALBGAZ pa pasur nevojën e një njoftimin paraprak. Zyrtari i Përputhshmërisë ka marrë pjesë në një pjesë të madhe të mbledhjeve të drejtuesve të ALBGAZ dhe organeve korporative, përfshirë asamblenë e përgjithshme, organet mbikqyrëse dhe drejtuese, të cilat e kanë informuar Zyrtarin e

Përputhshmërisë paraprakisht për takimet e programuara dhe i ka siguruar të gjithë informacionin dhe materialet e nevojshme për të marrë pjesë në takime. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij, Zyrtari i Përputhshmërisë ka dhënë opinionin e tij në lidhje me disa dokumenta të brendshëm si dhe veprime të ALBGAZ në lidhje me përputhshmërinë e tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e ALBGAZ, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshilltarët kanë konfirmuar me shkrim që janë të informuar për Programin dhe që do ta zbatojnë atë. Të gjithë drejtuesit e ALBGAZ dhe punonjësit janë udhëzuar rregullisht për zbatimin e këtij programi të paktën një herë në vit. Drejtuesit e rinj dhe punonjësit janë udhëzuar për programin nga Zyrtari i Përputhshmërisë para se të fillojnë mandatin e tyre.

PJESA E DYTË

4. Rekomandimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë

Në raportin e vitit 2020, ALBGAZ ka plotësuar të gjitha rekomandimet por rekomandimet e mëposhtë do jenë gjithmonë të aktive dhe koherente.

- **Paraqitja e teknikave të reja për trajnimet e stafit dhe zgjerimi i burimeve njerëzore**

Zyrtari rekomandon ALBGAZ që çdo vite të bëj dhe mbaj trajnime të ndryshme stafit si nga brenda dhe nga jashtë për të bërë up skilling të stafit. Gjithashtu dhe Zyrtari do trajnojë për pjesën e tij.

- **Përmirësimi i Kodit të Etikës duke përfshirë dhe Programin**

Kodi i Etikës aktual i përdorur nga ALBGAZ është shumë i mirë por kërkon një përmirësim duke shtuar pjesë nga Programi i Përputhshmërisë. Do shikohet përgjatë vitit 2021.

- **Përditësim/përmirësim i Programit**

Programi është një produkt i ri dhe kërkon sipas kohës të përditësohet dhe të kihet parasysh që të jetë sa më koherent me standardet e industrisë.

- **Mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e Programit**

Në kohën dhe momentin e duhur mendoj që ky rekomandim do ishte shumë i vyer.

PJESA E TRETË

6. Detyrat specifike të lëna nga ERE mbas miratimit të Raportit 2020.

Disa probleme për të ardhmen në sektorin e gazit natyror të cilat do jenë si detyra për Zyrtarin janë si më poshtë:

Bashkëpunimi me Entet Rregullatore të Energjisë së shteteve fqinje, Greqi dhe Itali, si dy shtete anëtare të BE-së, koordinimi i të gjitha akteve nënligjore dhe rregulloreve në përputhje me Direktivën 2009/EU dhe Rregulloren 715/EU, dhe një sërë rregulloresh të tjera që kanë të bëjnë me transparencë, diskriminimin e palëve të treta si dhe marjen e vendimeve të përbashkëta për këtë qëllim

- Bashkëpunimi me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vienë për akte e tjera të nënligjore dhe përmirësimin e atyre ekzistuese si dhe konsulenca e vazhdueshme për problemet që dalin gjatë implementimit të Direktivave dhe të Rregulloreve
- Bashkëpunimi me Ministrinë së linjës(MEI) për domosdoshmërinë e ndërtimit të infrastrukturës së gazit, si një nevojë urgjente për hapjen e tregut të gazit natyror në vëndin tonë. Aktualisht gazi është prezent dhe duhet që të filloj përdorimi i tij. Janë identifikuar pesë projekte prioritare të miratuara edhe nga Këshilli i Ministrave dhe kërkohet fillimi i ndërtimit të tyre, sigurisht sipas prioritetit që ato kanë.
- Bashkëpunimi me Ministrinë e linjës (MIE) për amendimin e ligjit nr.102/2015 ‘Për Sektorin e Gazit Natyror’, ndryshuar, për plotësimin e kushteve të çertifikimit të Operatorit të Transmetimit të Gazit Natyror, Albغاز sh.a.
- Bashkëpunimi me Albغاز sh.a, në aspektin rregullator, për të gjitha problemet që hasen për hapjen e tregut të gazit natyror, kualifikimin, transparencën dhe përmirësimin e akteve të domosdoshme.
- Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare dhe Ndërkombëtare për problemet e gazit si; CEER (Këshilli European i Rregullatorëve të Energjisë), ACER(Agency for the Cooperation of Energy Regulators) Agjencia për Kooperim e Rregullatorëve të Energjisë për Europën), GRI SSE, SOUTH SOUTH-EAST GAS REGIONAL INITIATIVE(GRI SSE, (Inisiativa e Rregullatorëve për Grupin e Gazit për Rajonin Jug-Jug lindje), MEDREG, Working Group Gas Natural, Shoqata e Rregullatorëve të Energjisë dhe të Gazit Natyror për rajonin e Mesdheut, ENTSO-G (Observër në Shoqatën e Sistemit të Transmetimit European të gazit), IGU (Unioni Ndërkombëtar i Gazit), OME (Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë), ECRB, Gas Working Group, Bordi i Rregullatorëve të Energjisë të vëndeve të Komunitetit të Enrgjisë, marja pjesë në studimet e tyre dhe mundësia e thithjes së investimeve të huaja për zhvillimin e infrastrukturës në vëndin tonë.

PJESA E KATËRT

7. Konkluzione

Raporti i parashtruar përcakton se, në vitin 2020 (viti i tretë i zbatimit të Programit të Përputhshmërisë), ALBGAZ ka filluar dhe vazhduar me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në mënyrë të saktë që nga dita e çertifikimit të tij. Drejtuesit dhe Stafit i kompanisë, kanë ndjekur në masë të madhe kuadrin rregullator specifik të ofruar nga Programi.

Raporti i vitit 2020 nuk nxjerr në pah ndonjë shkelje apo nuk konstaton që ALBGAZ të ketë shkelur apo të mos këtë plotësuar kërkesat për përputhshmërinë e kompanisë.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2020

Përgjatë vitit 2020 në funksionim e shoqërisë ALBGAZ kanë ndodhur shumë ndryshime dhe përmirësime. Mund të themi që dhe 2020 ka lënë hapur të vetmin problematikë – çertifikimin dhe licensimin e ALBGAZ.

Duhet theksuar që ALBGAZ, nën dijeninë e Zyrtarit, është në komunikim të rregullt me ERE për plotësimin e kërkesave ligjore. Zyrtari është marrë me koordinimin e komunikimit me ERE, me autoritetet e tjera kompetente, pjesëmarrësit ose me palët e treta që kanë lidhje me zbatimin e këtij Programi. Gjithashtu ALBGAZ ka komunikim të mirë me Zyrtarin për zbatimin dhe respektimin e programit, sa herë që kërkohej, si pjesë e detyrave të dala nga Programi. **Por kërkohet më shumë komunikim dhe informim ndaj Zyrtarit përsa i përket zbatimit të programit. Kjo është një nga sygjerimet që ALBGAZ duhet të përmirësojë në lidhje me zbatimet ligjeve dhe programit të përputhshmërisë.**

Në kushtet që ndodhet tregu i gazit në vënd, zhvillimi i aktivitetit të ALBGAZ dhe zhvillimi i tregut të gazit është një proces i rëndë si në volume projektimi dhe financimi. Kërkohen gjithashtu dhe burime njerëzore të mëdha dhe të kushtueshme, sëbashku me shtrirje kohore të zgjeruara. Por për të arritur këto rezultate në mënyrë graduale duhet që ALBGAZ të:

- Krijoj kushtet për përfitim të investimeve të huaja direkte në këtë segment të industrisë;
- Rritjen e punësimit në sektor dhe në industritë që kanë impakt prej sektorit të gazit;
- Përmirësimin e furnizimit me energji në nivel industrial, shërbimesh dhe rezidencial;
- Krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm industrial dhe ulje të ALBGAZosh energjitike në nivel prodhimi “mallrash dhe shërbimesh”;
- Ulje në përgjithësi e “faturës energjetike” të konsumatorit familjar fundor;
- Krijimin e kapaciteteve njerëzore në vënd në drejtim të para-projektimit, projektimit, menaxhimit të investimeve duke rezultuar në zbatimin efektiv dhe eficient të aktiviteteve përkatëse në industrinë e gazit.

Tiranë, 31.03.2021

Elvis Ponari, MBA, MSc

Zyrtari i Përputhshmërisë, ALBGAZ Sh.a